

1

E GABUESHME

Me regjimin pa viza, shtetasit e Republikës së Maqedonisë do të mund të udhëtojnë në tërë Bashkimin Evropian



E VËRTETA

Pa dallim që liberalizimi i vizave ia jep të drejtën shtetasve të Maqedonisë të udhëtojnë lirisht në zonën Shengen, disa shtete-anëtare të BE-së nuk janë integruar plotësisht në zonën Shengen (për shembull: Mbretëria e Bashkuar, që do të thotë se qytetarëve do tu nevojiten edhe më tej viza për hyrje). E vërteta është që pengesa kryesore e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Maqedonisë është gjendja e dobët ekonomike.

Megjithatë, përfitimet më të mëdha dhe më të rëndësishme nga qytetarët do të përjetohen kur Republika e Maqedonisë të bëhet anëtare fuqiplote e BE-së (për shembull: qasja e barabartë në tregun e punës dhe fondet strukturore, ku qasje kanë vetëm qytetarët e BE-së).

Nuk na nevojitet anëtarësimi në BE, meqë mund të jemi si Zvicra ose Norvegjia



E VËRTETA

Së pari, numri i shteteve evropiane që nuk janë anëtare të BE-së mund të numërohen në gishtërinjtë e njërës dorë. Zvicra dhe Norvegjia, të cilat nuk janë formalisht të lidhura me BE-në, lidhen në mënyrë tjetër të ngushtë, në tre aspekte: së pari, të dy shtetet janë pjesë e Zonës evropiane ekonomike; së dyti, ato duhet t'i zbatojnë të gjitha ligjet e BE-së dhe së treti, janë anëtare të zonës Shengen.

Së këndejmi, këto dy vende nuk janë aq të palidhura me BE-në, si që mendohet zakonisht. Çmimi i mosanëtarësimi të tyre është i lartë, meqë nuk kanë të drejtë të vendim-marrjes gjatë krijimit të politikave në BE.


Me anëtarësimin në BE, do të jetojmë më mirë, do të jemi më të lumtur, do të ketë më shumë punësime dhe më pak krim



E VËRTETA

Anëtarësimi në BE nuk do të thotë automatikisht që zgjidhen të gjitha problemet e shtetasve të Maqedonisë. Nuk është e kotë që Bashkimi Evropian i ka përcaktuar të a.q. Kriteret e Kopenhagës për anëtarësim (institucionet funksionale, sundimi i të drejtës, respektimi i demokracisë, ekonomia konkurruese e tregut, sundimi i mirë i gjyqësisë dhe pushtetit, të cilët e zbatojnë legjislacionin evropian në mënyrë të përpiktë dhe marrin pjesë në krijimin e ardhmërisë së Bashkimit Evropian). Duke i plotësuar këto kritere, Maqedonia "mëson" si të bëhet pjesë e familjes më të madhe evropiane, afaristët "mësojnë" si ta shfrytëzojnë tregun e 500 milion konsumatorëve, studentët "mësojnë" aftësi që janë të nevojshme në BE, shkencëtarët dhe hulumtuesit "mësojnë" si të hulumtojnë për ardhmërinë më të mirë të Evropës, artistët "mësojnë" së bashku me artistët tjerë të BE-së për begatimin e kulturës evropiane dhe qytetarët "mësojnë" për përfshirjen aktive në krijimin e ardhmërisë së përbashkët evropiane.

Bashkimi Evropian nuk ka për qëllim ta pranojë Republikën e Maqedonisë



E VËRTETA

BE e ka shprehur në mënyrë qartë dhe në mënyrë të padyshimtë gatishmërinë për pranimin e shteteve të Ballkanit perëndimor, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë. Strategjia për realizimin e këtij qëllimi quhet Agjenda e Selanikut, që mbështetet nga disa instrumente financiare të BE-së, me të cilat ndihmohet arritja e shteteve tek anëtarësimi. Porositë politike, veçanërisht për Republikën e Maqedonisë, janë shumë të qarta. Të rikujtojmë, Romano Prodi personalisht e solli Pyetësozin për Maqedoninë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Evropian në vitin 2004; Oli Rehn personalisht na i solli 8 kriteret për marrjen e rekomandimit për fillimin e negociatave, në mars të vitit 2008; Michael Lee, Drejtori gjeneral për zgjerim dhe Jelko Kacin na kanë vizituar rregullisht dhe kanë ushtruar lobim të vazhdueshëm për Maqedoninë në Parlamentin Evropian; Mirek Topolanek, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Çekisë nuk ka harruar ta cekë shtetin tonë në cilësinë e Kryetarit të Këshillit evropian, duke rikonfirmuar që Maqedonia nuk do të harrohet gjatë kryesisë suedeze.

Bashkimi Evropian pranon vetëm shtete me ekonomi të fuqishme



E VËRTETA

Përkundrazi, kujtoheni ku ishte Irlanda, Greqia, Spanja, Portugalia dhe shtetet tjera para anëtarësimit në BE. Të gjitha ishin ekonomikisht të pazhvilluara, madje edhe të varfra, por u pranuan në BE. Pas anëtarësimit, të gjitha këto shtete shënuan zhvillim të dukshëm ekonomik. Irlanda e vogël, izoluar, bujqësore dhe e varfër i shfrytëzoi me aftësi të gjitha mundësitë e ofruara nga BE dhe u shndërrua në "çudi" për të cilën tani mësohet në librat e ekonomisë. Rrëfimi i Spanjës është i ngjashëm – nga shteti i përndjekur, Spanja sot është prodhuesi dhe eksportuesi më i madh i ullinjve në botë.

Rasti me shtetet e Evropës qendrore dhe lindore e konfirmon faktin që niveli i zhvillimit ekonomik nuk është faktor vendimtar për anëtarësim. BE pret nga shtetet-kandidate të kenë dhe ta zbatojnë strategji ekonomike për zhvillim, si dhe të zhvillim të vazhdueshëm, qoftë edhe të vogël. Tjetra arrihet së bashku! Për këtë arsye, Republika e Maqedonisë e harton Programin nacional për zhvillim, si dhe Programin ekonomik trevjeçar për para-anëtarësim, që shqyrtohet dhe mbindërtohet rregullisht, së bashku me BE-në. Në këtë mënyrë, shteti tregon që është i aftë ta përcjellë planin e vet zhvillimor, kurse BE ndihmon përmes financimit të projekteve sipas nevojave të shtetit.

6

E GABUESHME

Pas zgjerimit të fundit,
BE është jofunksionale



E VËRTETA

Pa dallim nga rritja e numrit të shteteve-anëtare prej 15 në 25, gjegjësisht 27 (në vitin 2007), BE e ka mbajtur shpejtësinë e njëjtë të efikasitetit. Deri tani nuk është vërejtur asnjë ndërprerje në aktivitetin e BE-së që lidhet me zgjerimin. Hulumtimet e fundit të BE-së për rezultatet e zgjerimit me shtetet e Evropës qendrore dhe juglindore tregojnë për efektet pozitive në zhvillimin e ekonomisë evropiane. Dëshmi për funksionimin e BE-së është solidariteti, i cili në kushtet aktuale të krizës ekonomike dhe financiare po manifestohet nga shtetet-anëtare. Mos-harimi i zgjerimit dëshmohet edhe nga nisma e fundit e BE-së për t'i ndihmuar vendet e Ballkanit perëndimor me mjete plotësuese speciale, për tejkalimin më të lehtë të krizës.

7

E GABUESHME

Pas zgjerimit të fundit, shumë punëtorë kaluan nga Evropa lindore në pjesën perëndimore



E VËRTETA

Vetë procesi i zgjerimit të BE-së mban llogari për zhvendosjen eventuale të punëtorëve nga Evropa lindore në perëndim dhe për këtë arsye parashihen të a.q. periudha kalimtare, për integrimin e tregjeve të forcës së punës në BE. Faktet flasin që migracioni i punëtorëve nga shtetet e reja anëtare në shtetet e vjetra nuk është më tepër se 1% e popullatës aktive të aftë për punë në shtetet "e vjetra" anëtare. Ka shumë arsye për këtë, por me siguri niveli i ulët i migracionit ndodh kryesisht për shkak se në procesin e anëtarësimit, shtetet-kandidate zhvillohen ekonomikisht dhe kështu zvogëlohet papunësia. Ky proces mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe në rrethana të këtilla, nuk ekziston nevojë reale për migrimin e popullatës.

Republika e Maqedonisë nuk do të mund ta bart peshën financiare nga anëtarësimi në BE



E VËRTETA

Procesi i negociatave për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë është përgatitje e gjerë për anëtarësim. Kuptohet, anëtarësimi në cilëndo organizatë ndërkombëtare jep disa të drejta, por edhe obligime financiare. Për fat, Bashkimi Evropian kupton që të gjitha shtetet nuk kanë fuqi të barabartë financiare dhe ekonomike, kështu që edhe kontributi i tyre në buxhetin e përbashkët nuk përcaktohet në shumë absolute, por shprehet në përqindje të prodhimit të tyre bruto-nacional. Thënë ndryshe, shtetet më të pasura paguajnë më tepër dhe shtetet më të varfra, më pak. Në vitet e para pas anëtarësim-it, shtetet e reja anëtare si më pak të zhvilluara, shfrytëzojnë mjete disa herë më të mëdha, me qëllim të forcimit të ekonomisë, në krahasim me kontributin e tyre në buxhetin e BE-së. Edhe këtu e shohim në vepër parimin e solidaritetit! Kështu, Gjermania dhe Holanda janë "neto-paguesit" më të madh të BE-së, që do të thotë më së shumti kontribuojnë në buxhetin e përbashkët, edhe pse në proporcion shfrytëzojnë më së paku të holla.

Zëri i Maqedonisë nuk do të dëgjohej në BE, meqë Maqedonia është shtet tepër i vogël



E VËRTETA

Vendim-marrja në institucionet e BE-së është e dizajnuar në mënyrë që është pothuajse e pamundur që disa shtete të mëdha të imponojnë vetëm ndonjë vendim të tyre, duke mos i respektuar shtetet më të vogla anëtare. E njëjta vlen edhe për shtetet e vogla. Pa dallim bashkimeve, ato nuk kanë vota të mjaftueshme për bllokimin e shteteve të mëdha anëtare. Kjo baraspeshë arrihet me të a.q. shumicë të dyfishtë. Numri i votave i çdo shteti-anëtar varet nga madhësia dhe numri i popullatës. Njëra shumicë është sipas "peshës" së çdo shteti-anëtar, kurse shumica e dytë duhet të përfaqësojë 62% nga numri i popullatës në Bashkimin Evropian.

Bashkimi Evropian e rrezikon identitetin e shteteve të vogla



E VËRTETA

BE kujdeset për identitetin e shteteve të vogla dhe pakicat në shumë mënyra, duke filluar nga motoja zyrtare e BE-së ("Të bashkuar në dallime"), numri i gjuhëve zyrtarë në BE (23 gjuhë nga 27 shtete-anëtare) deri te programet për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe aksioneve për promovimin e pakicave. Kështu, pa dallim që BE e kupton qartë që përktimi i tërë dokumentacionit voluminoz në të gjitha gjuhët e BE-së është punë e shtrenjtë, nuk heq dorë nga ky shpenzim i jashtëzakonshëm, meqë beson se në këtë mënyrë promovohen dhe mbrohen më së miri identitetet e secilit grup. Jemi dëshmitarë që viteve të fundit është "ngjallur" gjuha irlandeze, tashmë e harruar.

Ekonomia evropiane nuk është udhëheqëse në botë dhe nuk kemi nevojë t'i bashkëngjitemi asaj



E VËRTETA

BE sot është blloku më i madh tregtar dhe ekonomik në botë, duke kapur 1/3 e ekonomisë globale. Euroja është valuta e dytë më e fuqishme në botë. Gjithashtu, Bashkimi Evropian e ka përcaktuar si qëllim të jetë ekonomia më konkurrense në Evropë (Strategjia e Lisbonës) dhe të gjitha mjetet e kornizës buxhetore 2007-2013 orientohen për arritjen e këtij qëllimi. Pse? Duke qenë e vetëdijshme që jetojmë në erën e globalizimit, Bashkimi Evropian e ka zhvilluar modelin e saj si përgjigje ndaj globalizimit, që është solidar dhe i drejtë. Ndërlidhja dhe ndër-varësia që imponohet nga globalizimi i ka detyruar të gjitha shtetet e botës të "grupohen" në ndonjë bazë të caktuar, në pajtim me sistemet e tyre të vlerave. Me këtë logjikë, edhe ne duhet të vendosim se në cilin "klub" do t'i realizojmë më së miri qëllimet tona, meqë është e qartë se nuk mund të vazhdohet "vetëm".

Perimet e Maqedonisë nuk do të mund të shiten në tregjet evropiane, nëse nuk i plotësojnë standardet e formës



E VËRTETA

Nuk janë të gjitha trangujt në Evropë të drejta dhe nuk ekziston asnjë formë ideale që duhet ta kenë domatet, për tu shitur në tregun evropian. Ekzistojnë vetëm rregulla për cilësi, që duhet të përmbushen nga prodhimet që shiten në tregun evropian. Kjo bëhet, kryesisht, me qëllim të mbrojtjes së blerësve dhe për këtë arsye, pa dallim a janë organike ose jo, pemët duhet të arrijnë një nivel të pjekurisë për t'i plotësuar standardet. Nëse prodhimet shiten në tregun e gjerë të BE-së, duhet të aplikohen kritere më të rrepta, por edhe më të sigurta. Tregu evropian ka vlerësim të posaçëm për prodhimet vendase cilësore dhe të njohura.

Pas anëtarësimit në BE,
do të ndalohet pjekja e rakisë shtëpiake



E VERTETA

Qytetarët që dëshirojnë të prodhojnë raki në shtëpi për shitje, duhet së pari ta përshtasin prodhimin ndaj legjislacionit të Maqedonisë, që gjithashtu përmban rregulla më të rrepta për shënimin e qartë të pijeve alkoolike. Rregullativa e BE-së nuk e rregullon drejtpërdrejtë prodhimin e pijeve alkoolike për nevojat e veta, por kur flitet për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shëndetit, rregullativat evropiane janë shumë të rrepta. Kuptohet, pjekja tradicionale e rakisë për nevoja personale nuk do të preket.

BE do ta ndalojë traditën e therjes së gjedhit në kushte shtëpiake



E VËRTETA

Pas anëtarësimit në BE, do të mundësohet vazhdimi i ushtrimit të traditës së therjes së gjedhit në kushte shtëpiake. Nuk do të ndalohet as prodhimi i prodhimeve të mishit (salsiçet, suxhuku, etj) në kushte shtëpiake, nëse dedikohet për nevoja personale. Por, mishti i dedikuar për treg (mishtore, shitore dhe tregje) patjetër duhet të vjen nga thertoret dhe objektet për përpunimin e mishit, që punojnë sipas rregullativave të BE-së për higjienë, mbrojtje të konsumatorëve dhe shëndet dhe mirëqenie të kafshëve. Rregullativat e BE-së që e rregullojnë therjen e gjedhit janë shumë të përpikta dhe nuk e lejojnë mundimin e kafshëve.

Burokracia e Brukselit është e fryre, për të cilën shpenzohet pjesa më e madhe e të hollave evropiane



E VËRTETA

Në institucionet e BE-së punojnë vetëm rreth 30.000 profesionistë me kualifikim të lartë, që është dukshëm më pak se administratat nacionale, madje edhe se pushtetet lokale të disa shteteve. Vetëm rreth 6% e buxhetit të BE-së shfrytëzohet për të punësuarit dhe shpenzimet administrative. Me fjalë tjera, të gjitha institucionet evropiane "kushtojnë" 5,5 euro-centë për çdo euro të shpenzuar nga buxheti i BE-së. Për ilustrim, buxheti i BE-së i kushton çdo qytetari rreth 235 euro në vit, për dallim nga buxheti i Maqedonisë, që i kushton rreth 1.330 euro në vit çdo qytetari ose rreth 5 rroga mesatare. Me 95% tjera të mjeteve financohen aktivitetet e ndryshme në shtetet-anëtare, si që është bujqësia, arsimi, kultura, infrastruktura, punësimi dhe mbrojtja sociale, mbrojtja e mjedisit jetësor, etj.

Buxheti evropian është thes pa fund dhe shpenzohet pa kontroll



E VËRTETA

Buxheti i BE-së është në përgjithësi shumë më i vogël nga ajo që mendohet, duke u mbushur nga burime të ndryshme (përqindja e të hyrave bruto nacionale, përqindja e TVSH-së dhe taksave doganore). Me 80% të shpenzimeve buxhetore menaxhojnë vetë shtetet-anëtare të BE-së dhe jo institucionet evropiane. Në fakt, organet nacionale, rajonale dhe lokale të shteteve-anëtare i zgjedhin vetë projektet dhe shfrytëzuesit e mjeteve dhe ata duhet të kujdesen për shfrytëzimin gjegjës të mjeteve, ndërkohë që Komisioni Evropian e realizon buxhetin. Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Ministrave marrin raporte interne vjetore nga Komisioni dhe raportet speciale auditore të jashtme, nga ana e Gjyqit evropian të auditorëve, për mënyrën e shpenzimit të të hollave evropiane. Kështu zbatohet kontrolli i shpenzimeve nga buxheti i BE-së. Përveç kësaj, buxheti evropian programohet në periudhë afatgjate dhe jo në nivel vjetor, me çka pothuajse pamundësohet shpenzime joadekuat i mjeteve.

17

E GABUESHME

Institucionet e BE-së janë tepër të fuqishme dhe jodemokratike, ato punojnë në interes të shteteve-anëtare



E VËRTETA

Për të siguruar më shumë demokraci në BE, në vitin 1979 janë përcaktuar zgjedhjet direkte për në Parlamentin Evropian, me qëllim të mbrojtjes së interesave të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Këshilli i BE-së, nga ana tjetër, i përfaqëson interesat nacionalë të shteteve-anëtare, kurse Komisioni Evropian i mbron interesat evropianë. Për punën e vet, Komisioni Evropian i përgjigjet Parlamentit Evropian, me çka sigurohet kontrolli demokratik. Aplikohet edhe i a.q. parim i supsidiaritetit, që nënkupton se problemet zgjidhen në nivelin më të ulët të mundshëm të pushtetit (lokal, rajonal, nacional ose në nivel të BE-së), duke mbajtur llogari për nivelin që mund të jep rezultate më të mira dhe më të shpejta. Shtetet-anëtare e bartin zgjidhjen e problemeve konkrete çdoherë e më shumë në nivel evropian.

Afaristët e Maqedonisë nuk do ta përballin konkurrencën në tregun e BE-së.



E VËRTETA

Në tregun e BE-së, afaristët e të gjitha shteteve-anëtare të BE-së garojnë me kushtet e njëjta. Për ta rritur konkurrencën, ndërmarrjet detyrohen ta modernizojnë punën e tyre, të investojnë në zhvillim dhe në burime njerëzore. BE i mbështetë përpjekjet e tyre përmes ndihmës së aksioneve dhe fondeve të ndryshme. Kështu, ata e rrisin konkurrencën, krijojnë më shumë vende pune dhe ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të shtetit të vet, njëherazi edhe BE-së. Anëtarësimi në BE e nënkupton edhe qasjen në tregun më të madh, dituritë e reja, teknologjitë e reja, etj. Kompanitë që do të jenë të afta t'i shfrytëzojnë këto përparësi, do të mund të ballafaqohen me konkurrencën në tregun e BE-së. Afaristët e Maqedonisë mund t'i shfrytëzojnë edhe fondet IPA për ristrukturim të hershëm, duke e pasur mundësinë e konkurrimit me kolegët e tyre evropianë.

**BESIMET E
GABUSHEME
MBI
BASHKIMIN
EVROPIAN**

Republika e Maqedonisë e ka fituar statusin e shtetit-kandidat në vitin 2005. Që atëherë kanë kaluar më shumë se pesë vite dhe shteti ende nuk i ka filluar bisedimet për anëtarësim.

Projekti "Aksioni për Evropë" ka për qëllim të jep kontribut në ngritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e përsheptimit të procesit të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Kjo broshurë duhet t'i thyejë lajthitjet e lidhura me institucionet evropiane, procesin e anëtarësimit, politikat e përbashkëta, përparësitë që i sjell anëtarësimi, si dhe t'i sigurojë informata të sakta për qytetarët dhe t'i vendos si duhet copëzat e gjëzës së quajtur - Bashkimi Evropian

Boton:
**Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur
- Maqedoni**
Për botuesin:
Vladimir Milçin, Drejtor ekzekutiv
Autorë:
Qendra maqedonase për arsim evropian

Përkthimi:
ABAKUS
Formësimi artistik-grafik:
Brigada Dizajn
Shtyp:
Skenpoint
Tirazhi: 4200 copë

CIP - Katalogizimi i publikimit
Biblioteka nacionale dhe universitare "Sh. Kliment Ohridski" Shkup
341.171(4-672EU) (035)
Besimet e gabueshme për Bashkimin Evropian/ - Shkup
Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur Maqedoni, 2009. - 18 str., illustr. : 20 sm.
ISBN 978-9989-185-94-6
a) Bashkimi Evropian - Doracakët
COBISS.MK-ID 77743626